



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 15.7.2026, merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet ndarja e mjeteve financiare për NPL “Prishtina Parking” SH.A.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, shuma e mjeteve të ndara është në vlerë prej 100.000,00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere – kod 16306.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, pjesë përbërëse janë: kërkesa e parashtruar për subvencionim nga NPL “Prishtina Parking” SH.A. 02 nr. 343 e datës 25.06.2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-106248/26, më 16.7.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



ARSYETIM

Bazuar në kërkesën e parashtruar nga NPL "Prishtina Parking" Sh.A. sipas të cilës rezulton se ndërmarrja është përballur me rënie të ndjeshme të të hyrave si pasojë e shfuqizimit të një pjese të Rregullores nga Gjykata Supreme e që ka ndikuar drejtpërdrejt në gjendjen e saj financiare dhe në aftësinë për përmbushjen e obligimeve të akumuluar. Në këto rrethana, subvencionimi nga Komuna e Prishtinës në vlerë prej 100,000 € është i nevojshëm për mbulimin e obligimeve emergjente dhe sigurimin e vazhdimësisë së operimit.